



Sipas autoritetit të dhënë sipas Nenit 15 dhe 58.7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në sesionin e mbajtur më **27.05.2009** ka miratuar:

## **RREGULLA MBI SHKYÇJEN DHE RIKYÇJEN E KONSUMATORËVE NË SEKTORIN E ENERGISË NË KOSOVË**

### **Kapitulli 1: KUSHTET E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Objektivi**

Rregulla vë kriteret me anë të cilave ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë dhe të rikyçë sërish konsumatorët në sektorin e energjisë në Kosovë dhe të vendosë standarde, parime dhe procedura të aplikueshme.

#### **Neni 2**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i Rregullës është që të vendosë termat, kushtet dhe procedurat në lidhje me shkyçjen dhe rikyçjen në rrjet, në mënyrë që:

- a). të sigurojë kryerjen e veprimeve transparente dhe jo diskriminuese të shkyçjes dhe rikyçjes nga ndërmarrjet e energjisë .
- b). të mbrojë konsumatorët përmes mundësimit të qasjes transparente dhe të hapur në informacionet që kanë të bëjnë me shkyçjen dhe rikyçjen në rrjete, dhe;
- c). të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë konsumatorëve në Kosovë, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me shkyçjen dhe rikyçjen.

#### **Neni 3**

##### **Definicionet**

**3.1.** Shprehjet e përdorur në këtë rregull do të kenë kuptimet e mëposhtme:

**“Konsumator Familjar”** është çdo person fizik që përdor energjinë për konsum personal familjar, duke përfshirë aktivitetet tregtare ose profesionale.

**“Konsumator jo familjar”** është çdo person fizik ose ligjor që blen energji jo vetëm për përdorim personal familjar, por edhe për qëllime prodhuese dhe komerciale, si dhe konsumatorët e blerjes me shumicë.

**“Grup i kualifikuar”** është një grup konsumatorësh në një zonë gjeografike të veçantë të furnizimit me energji, të cilët ndajnë një kycje ose pika të shpërndarjes të përbashkëta në një ndërmarrje të energjisë, në të cilin të paktën 90% e energjisë së dërguar në pikën e liferimit nuk është paguar minimum për së paku Tre (3) muajt paraprak.

**“Njoftim paralajmërues”** është njoftimi që përmban dispozita sipas Nenit 15 të kësaj Rregulle, që një ndërmarrje e energjisë (Furnizuesi) i bën konsumatorit, përpara nxjerrjes së njoftimit për shkyçje, duke i dhënë një afat të arsyeshëm për të korrigjuar ose sfiduar arsyet e shkyçjes.

**“Njoftim për shkyçje”** është njoftim i shkruar që përmban dispozita sipas Nenit 16 të këtij Rregulli, që një ndërmarrje e energjisë (Furnizuesi) i jep konsumatorit pas skadimit të periudhës paralajmëruese, por përpara shkyçjes

**“Shkyçja”** është shkyçja e një lidhjeje fizike midis objektit të konsumatorit dhe një rrjeti të transmisionit apo shpërndarjes që ekzekutohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me kërkesë të Furnizuesit;

**“Shkyçje Grupore”** është shkyçja e një grupi të caktuar të konsumatorëve.

**“Kycje e paautorizuar”** është një kycje midis objektit të një konsumatori dhe një rrjeti shpërndarës të energjisë, që nuk është e autorizuar ose e miratuar nga ndërmarrja e energjisë.

**“Energji”** është çdo formë e energjisë e prodhuar ose e siguruar (energji elektrike, ngrohje qendrore ose gazi natyror) për shitje ose furnizim;

**“Ndërmarrje e Energjisë”** është çdo ndërmarrje e energjisë që kryen shpërndarjen, furnizimin publik, furnizimin ose tregtimin me energji elektrike, ngrohje qendrore ose gazit natyror me anë të licencës së lëshuar prej Zyrës së Rregullatorit për Energji.

**“Shërbim i Energjisë”** është shërbimi me energji të prodhuar ose të përfutur që është për furnizim ose shitje.

**“Rrjet”** është çdo pronë e përdorur në lidhje me sigurimin dhe/ose marrjen e energjisë që i përket ose fushës publike ose ndërmarrjes së energjisë.

**“Marrëveshje Pagese”** është një marrëveshje midis një konsumatori të energjisë dhe një ndërmarrjeje të energjisë (Furnizuesin), për pagimin e borxhit.

**“Furnizues”** është çdo ndërmarrje e energjisë që kryen furnizim, furnizim publik / tregtime me energji elektrike, ngrohje ose gaz natyror;

- 3.2.** Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregull do të kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe, Ligjin e Ngrohjes Qendrore.

#### **Neni 4**

##### **Parimet e përgjithshme të Shkycjes dhe Rikycjes**

- 4.1.1.** Rregulla përcakton disa parime të përgjithshme që duhen aplikuar prej ndërmarrjes së energjisë, ndërsa shkyç konsumatorët dhe rendit arsyet dhe rastet kur shkyçja aplikohet. Çdo ndërmarrje e energjisë inkurajohet që të zhvillojë politika specifike për shkyçjen, që i trajton konsumatorët me respekt dhe në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese. Politika të tilla, duhet të paraqiten në ZRRE për shqyrtim, dhe kjo e fundit duhet t'i miratojë përpara se të aplikohen.
- Në këtë Rregull operatori i sistemit shpërndarës kryen veprimin e shkyçjes dhe rikycjes, hulumtimin e kyçjeve dhe shfrytëzimit të paautorizuar, dhe heqjen e pajisjeve.
- Të gjitha veprimet tjera që parashihen në këtë Rregull kryhen nga Furnizuesi.
- 4.2.** Rregulla paraqet vetëm parimet që janë të lidhura drejtpërdrejtë me shkyçjen dhe me rikycjen. Të gjitha kushtet tjera lidhur me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, përfshihen në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, nxjerrë dhe miratuar nga ZRRE.
- 4.3.** Shkyçja është një mundësi që i lejohe ndërmarrjes së energjisë; nuk është një kusht që i vihet ndërmarrjes së energjisë prej ZRRE-së. Ndërmarrja e energjisë, mund të zgjedhë të vendosë masa më pak kufizuese mbi konsumatorët, sesa atë që dalin nga Rregulla.
- 4.4.** Ndërmarrja e energjisë duhet të përpiqet të marrë përsipër të gjithë hapat e nevojshëm, përfshirë zbatimin e gjobave, ku këto të fundit, ose veprime të tjera, mund të eliminojnë arsyet për shkyçje dhe të parandalojnë shkyçjen. Në rast të mospagimit, shkyçja duhet përdorur si mjet përfundimtar në rast se kanë dështuar të gjitha masat e vendosura në këtë Rregull dhe në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
- 4.5.** Për sa i përket kushteve të paralajmërimit dhe njoftimit për shkyçje, Rregulla nxjerr kushtet minimale që duhet të përmbushë një ndërmarrje e energjisë. Ndërmarrja e energjisë, sipas gjykimit të vetë, mund të sigurojë njoftim shtesë për të shtyrë periudhën kohore për paralajmërim dhe shkyçje.
- 4.6.** Rregulla, nxjerr gjithashtu kriteret e përgjithshme me anë të cilave ndërmarrja e energjisë i rikyç konsumatorët që i janë nënshtruar shkyçjes. Pasi që arsyet për shkyçje janë eliminuar, këta konsumatorë kanë të drejtë që sa më shpejt që është e mundur të rikyçen nga ndërmarrja e energjisë sipas termave dhe afateve të arsyeshme.
- 4.7.** Ndërmarrja e energjisë ka të drejtë të ngarkoj me tarifa konsumatorin për përgatitjen e njoftimeve të shkyçjes, dhe për aktivitetin e shkyçjes dhe rikycjes së konsumatorëve, në përputhje me Shtojcën 1: Tabela e Çmimeve dhe Gjobave.

- 4.8.** Ndërmarrja e energjisë obligohet të emëroj dhe t'i certifikoj punëtorët e vet që duhet të kenë autorizim të kyçin, shkyçin ose rikyçin një konsumator. Asnjë person, duke përfshirë edhe punëtorët tjerë të ndërmarrjes së energjisë, përveç atyre të emëruar dhe të certifikuar, nuk mund të kyçin dhe shkyçin ose rikyçin një konsumator në rrjetin e ndërmarrjes së energjisë. Emërimi dhe certifikimi i punëtorëve të autorizuar duhet të bëhet nga ndërmarrja e energjisë në baza periodike dhe emrat e punëtorëve të autorizuar do të publikohen në një mënyrë që siguron tërësisht të jenë në dijeni të konsumatorëve.
- Angazhimi i personave tjerë, përveç atyre të emëruar dhe të certifikuar, konsiderohet si një kundërvajtje dhe në raste të tilla do të zbatohen gjobat në pajtim me këtë rregull dhe ligjet tjera të zbatueshme.

## **Kapitulli 2: SHKYÇJA KOMERCIALE**

### **Neni 5**

#### **Shkyçja për shkak të Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë**

- 5.1.** Ndërmarrja e energjisë do të shkyçë konsumatorin i cili shfrytëzon energji në mënyrë të paautorizuar siç është përkufizuar në Nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji
- 5.2.** Ndërmarrja e energjisë mund të kryejë veprime në përgjigje të shfrytëzimit të paautorizuar në përputhje me Kapitullin 4 të kësaj Rregulle, dhe në pajtim me politikat dhe procedurat e brendshme të ndërmarrjeve të energjisë të aprovuara nga ZRRE.
- 5.3.** Konsumatori i cili shkyçet nga furnizimi me energji për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, dhe ky konsumator rikyçet në mënyrë arbitrare pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, atëherë këtij konsumatori do ti hiqen pajisjet për furnizim me energji në pajtim me Nenin 26 të kësaj Rregulle.

### **Neni 6**

#### **Shkyçje për Mos-pagesë të Energjisë**

- 6.1.** Ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë konsumatorin i cili nuk i përmbahet afateve të pagesës të përcaktuara në faturë apo në kontratën për furnizim, dhe në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
- 6.2.** Në rast se konsumatori paraqet prova të qarta të qarta të pagesës së faturave ose të këstit ndaj ndërmarrjes së energjisë sipas marrëveshjes së pagesës, arsye për të cilën është nxjerr edhe njoftimi shkyçës, atëherë ndërmarrja e energjisë nuk do të shkyçë këtë konsumator.

## **Neni 7**

### **Shkyçje për Arsye të Tjera Komerciale**

- 7.1.** Një ndërmarrje e energjisë mund të shkyçë një konsumator nëse ai:
- a). futet në kategorinë e konsumatorit jo-familjar, por është i regjistruar si konsumator familjar; ose
  - b). nuk ka paguar një depozitë garancie kur i është kërkuar nga ndërmarrja e energjisë, sipas kushteve të paraqitura në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
  - c). urdhërohet me vendim gjykate ose prej ndonjë autoriteti publik të autorizuar nga organet kompetente.

## **Neni 8**

### **Caktimi i Fondeve për Pagesat e Borxheve**

Në rast se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i siguron një konsumatori të varfër dhe të dëmtuar, ndihmë, me qëllim të mbulimit të pjesëshëm ose të plotë të borxheve që konsumatori ka ndaj ndërmarrjes së energjisë, ai është përgjegjës që t'i sjellë ndërmarrjes së energjisë, provat e kësaj ndihme. Ndërmarrja e energjisë do të marrë parasysht këtë ndihmesë duke vlerësuar përshtatshmërinë e shkyçjes.

## **Kapitulli 3:**

### **SHKYÇJA JO-KOMERCIALE**

## **Neni 9**

### **Shkyçja për Arsye të Rreziqeve ndaj Shëndetit dhe Sigurisë**

- 9.1.** Një ndërmarrje e energjisë është e autorizuar që të shkyçë menjëherë çdo konsumator, në rast se shkyçja është e nevojshme për të larguar ndonjë rrezik të menjëhershëm ndaj shëndetit dhe sigurisë së ndonjë personi fizik dhe / ose sigurisë të ndonjë pasurie.
- 9.2.** Kjo lloj shkyçjeje mund të përdoret në rast të ndonjë force madhore ose aksidenti material në instalimet e prodhimit, transmetimit ose shpërndarjen së energjisë, si dhe rreziqe të tjerë të mundshme.
- 9.3.** Menjëherë pas identifikimit të një rreziku për shëndetin ose sigurinë, ndërmarrja e energjisë, duhet të përpiqet të njoftojë të gjithë konsumatorët e prekur përpara se të bëjë shkyçjen. Në rast se rreziku është aq urgjent, saqë nuk mund të zbatohet njoftimi, ndërmarrja e energjisë do t'i informojë konsumatorët e prekur sa më parë që të jetë e mundur, për shkyçjen dhe do t'u shpjegojë arsyet dhe kohëzgjatjen e mundshme të shkyçjes.

- 9.4.** Ndërmarrja e energjisë do të bëjë rikycjen e konsumatorit pa asnjë shpenzim prej tij, menjëherë sapo të ketë bërë adresimin ose largimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë me anë të shkyçjes, përveç në rastet kur konsumatori është plotësisht ose pjesërisht përgjegjës, për krijimin e kushteve të rrezikshme që kanë çuar deri në shkyçje të energjisë.

#### **Neni 10**

##### **Shkyçja për arsye të Rrezikimit ose Dëmtimit të Rrjetit, ose Pajisjeve për**

##### **Furnizimin e Energjisë**

- 10.1.** Ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë objektin e çdo konsumatori për shkak të rrezikimit ose dëmtimit të centraleve të energjisë, rrjetit të energjisë ose njehsorit, në përputhje me Kodet relevante të nxjerra nga ndërmarrja e energjisë dhe aprovuar prej ZRRE-së
- 10.2.** Ndërmarrja e energjisë do të marrë të gjitha veprimet që të informojë të gjithë konsumatorët e prekur dhe do të paraqesë arsyet për shkyçjen sipas Nenit 10.1. Në rast se është i zbatueshëm, ky informacion do të sigurohet me shkrim përpara shkyçjes. Në rast se nuk është i zbatueshëm, ky informacion do të sigurohet menjëherë pas shkyçjes.
- 10.3.** Ky informacion me shkrim do të përmbajë periudhën e shkyçjes së mundshme. Kjo periudhë duhet të jetë e arsyeshme dhe e bazuar mbi rrethanat e rastit. Nëse shkak i shkyçjes nuk është larguar brenda periudhës së dhënë në informacion, periudha mund të shtyhet deri në përfundim të riparimit. Në rast se është e nevojshme që të shtyhet periudha e shkyçjes për arsye teknike, atëherë, konsumatori duhet informuar me shkrim sa më parë që të jetë e mundur.

#### **Neni 11**

##### **Shkyçje për Shkak të Braktisjes**

Në rast se ndërmarrja e energjisë identifikon një kyçje që nuk është më në përdorim për shkak të mos banimit, ose dëmtimit të madh strukturor, që pamundëson banimin e sigurt, atëherë ajo do të dërgoi me postë lajmërimin shkyçës në vendin fizik të kyçjes në fjalë.

#### **Neni 12**

##### **Shkyçja me anë të Kërkesës**

- 12.1.** Një konsumator ka të drejtë të kërkojë që ndërmarrja e energjisë ta shkyçë, lidhjen e tij nga rrjeti i energjisë.
- 12.2.** Në rast se një konsumator që ka bërë kërkesë për shkyçje, nuk i ka paguar plotësisht detyrimet e tij ndaj ndërmarrjes së energjisë, do të aplikohen dispozitat që kanë të bëjnë me taksat për gjokat e shkyçjes dhe rikycjes, siç paraqitet në Shtojcën 1, përveç në rastet kur bëhet një marrëveshje e ndarë pagese midis konsumatorit dhe ndërmarrjes së energjisë, për të vendosur kushte më të buta ndaj konsumatorit.

## Neni 13

### Shkycja për Arsye të Tjera Jo-komerciale

- 13.1.** Një ndërmarrje e energjisë mund të shkycë një konsumator, kur ky ka refuzuar të lejojë një përfaqësues të ndërmarrjes së energjisë që të hyjë në pronën apo në objektin e tij me qëllim të:
- a) kontrollimit të njehsorit apo pikës matëse,
  - b) ndonjë lidhjeje ose kontrollit të funksionimit të pajisjeve matëse, që i përkasin ndërmarrjes së energjisë ose konsumatorit,
  - c) kontrollit për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ose
  - d) kur siguria e konsumatorit ose e një personi tjetër, është në rrezik;
- 13.2.** Për grupin e konsumatorëve më të vogël të mundshëm, dhe periudhën kohore më të shkurtër të mundshme, ndërmarrja e energjisë mund të zvogëlojë ose pezullojë transmetimin ose shpërndarjen e energjisë, në rast të:
- a) keqfunksionimeve të instalimeve elektrike/te gazit natyror/ose instalimeve të ngrohjes;
  - b) kushteve të jashtëzakonshme në rrjet, në stacionin elektrik/stacionin e ngrohjes qendrore/ dhe problemeve në furnizimin me karburant.
  - c) kërkesës së lartë dhe mungesës së energjisë, por vetëm pasi ndërmarrja e energjisë e ka racionalizuar energjinë në dispozicion me anë të manovrimit më të mirë teknik dhe pas aprovimit të ZRRE, ose
  - d) rasteve të tjera të parapara në Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes ose Kodet relevante të aplikueshme varësisht nga rasti, e të miratuara nga ZRRE.
- 13.3.** Për të gjitha rastet e ndërprerjes/kufizimit të furnizimit me energji të paraqitura në Nenin 13.2, ndërmarrja e energjisë duhet të njoftoj ZRRE-në për:
- a) numrin e konsumatorëve të ndikuar,
  - b) kohëzgjatjen e ndërprerjes/kufizimit të furnizimit dhe
  - c) veprimet e ndërmarra për rikthimin e furnizimit normal.

## Neni 14

### Masat Kufizuese të Qeverisë

Qeveria mund të vendosë masa kufizuese për furnizimin me energji të konsumatorëve, ose mund të vendosë detyrime të veçanta mbi ndërmarrjet e energjisë, duke përfshirë shkycjen, sipas Nenit 25 të Ligjit mbi Energjinë dhe legjislacionit sekondar relevant të lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.

## **Kapitulli 4: PROCEDURA PËR SHKYÇJE**

### **Neni 15**

#### **Njoftimi Paralajmërues**

- 15.1.** Përpara shkyçjes, në rastet e përmendura në Nenet 6, 7, 11 dhe 13.1, do të nxirret një njoftim paralajmërues me ose në faturë për borxh të papaguar dhe me shpjegimin për metodën e rregullimit të mos-pagimit, ose një njoftim të veçantë paralajmërues ku arsyeja për shkyçje nuk është mos-pagesa.
- 15.2.** Njoftimi paralajmërues do të përfshijë njoftimin mbi masat që do të ndërmerren ndaj konsumatorit përfshirë shkyçjen, në rast se ai nuk kryen veprimet e specifikuar në paralajmërim, brenda një afati të përcaktuar kohor. Ajo periudhë kohore nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjete (15) ditë kalendarike prej datës së paralajmërimit të konsumatorit.
- 15.3.** Njoftimi paralajmërues do të përfshijë edhe të drejtën e konsumatorit për të kundërshtuar shkyçjen, dhe afatin përfundimtar për këtë kundërshtim. Ky afat për kundërshtim përcaktohet në Nenin 19 dhe do të fillojë prej ditës kur dëshmohet se konsumatori e ka marrë njoftimin.
- 15.5.** Mënyra e dorëzimit të njoftimit paralajmërues është përcaktuar në nenin 18.

### **Neni 16**

#### **Njoftimi për shkyçje**

- 16.1.** Pas kalimit të afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin paralajmërues sipas neni 15.2, dhe duke marrë parasysh afatin kohor për zgjidhjen e kontestit të përcaktuar në Nenin 19, ndërmarrja e energjisë është e obliguar të dërgojë te konsumatori një njoftim për shkyçje para se të ndërmarrë veprimin për shkyçje në këto raste:
- a) mos-pagesës së një fature energjie ose kësteve, siç përcaktohet në Nenin 6;
  - b) mos-pagesës së një depozite garancie të kërkuar nga ndërmarrja e energjisë sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- 16.2.** Njoftimi për shkyçje nuk është i domosdoshëm në rrethanat e mëposhtme:
- a) rreziqe shëndeti dhe sigurie të personave, siç përcaktohet në Nenin 9 të kësaj Rregulle;
  - b) me anë të kërkesës së konsumatorit;
  - c) shfrytëzim i paautorizuar i energjisë;
  - d) kur paraqiten prishje apo dëmtim të rrjetit ose të pajisjeve, ose për qëllime të operimit dhe mirëmbajtjes;
  - e) braktisja ose aty ku kyçja nuk është më në përdorim;
  - f) kur refuzohet ti lejohet qasja në pronë, përfaqësuesit të ndërmarrjes së energjisë për qëllim të leximit dhe kontrollimit të njehsorit

- 16.3.** Duke iu referuar Nenit 16.2 pika a) dhe d), ndërmarrja e energjisë duhet të përgatisë një shpjegim me shkrim për arsyet e ndërprerjes së shërbimit dhe atë ta publikoi në mjete të informimit apo në vende publike, cila do që është më e përshtatshme. Për pikat b), c), e) dhe f) të Nenit 16.2, arsyetimi me shkrim duhet të vendoset në dosjet e konsumatorëve.
- 16.4.** Njoftimi për shkyçje duhet të dorëzohet me shkrim tek konsumatori të paktën tri (3) ditë kalendarike përpara datës së përcaktuar të shkyçjes në njoftim.

## **Neni 17**

### **Përmbajta e Njoftimit për Shkyçje**

Njoftimi për shkyçjen e një konsumatori të energjisë, do të përmbajë si vijon:

- a) emrin e konsumatorit dhe numrin e njehsorit;
- b) arsyen dhe bazat ligjore për shkyçje;
- c) adresën dhe informacionin kontaktues të zyrës ku konsumatori mund të marrë më
- d) shumë informacione dhe/ose të tregojë se janë marrë masat e kërkuara (nëse ka pasur);
- e) një shpjegim të veprimeve që duhet të ndërmarrë konsumatori për të parandaluar shkyçjen
- f) kushtet dhe procedurat që duhet të përmbushë konsumatori, për të kërkuar rikyçjen;
- g) Informatën mbi të drejtën e konsumatorit për të parashtruar ankesë kundër ndërmarrjes së energjisë për të shmangur ose kundërshtuar shkyçjen, në pajtim me Procedurat për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe
- h) në rast të mirëmbajtjes së planifikuar, fillimin dhe fundin e periudhës së shkyçjes së paraparë.

## **Neni 18**

### **Metoda e Dërgimit dhe Marrjes së Njoftimeve**

- 18.1.** Ndërmarrja e energjisë do të dërgojë paralajmërimin dhe njoftimin për shkyçje në këtë mënyrë:
- a) duke ia dërguar me postë konsumatorit në adresën nga regjistri i ndërmarrjes së energjisë; ose
  - b) duke e dërguar personalisht te konsumatori, dhe duke kërkuar që konsumatori të nënshkruhet në regjistrin e pranimit të dërgesave, kjo gjithnjë kur është e mundur.
- 18.2.** Në lidhje me Nenin 18.1 ndërmarrja e energjisë do të marrë veprime për tu bindur se paralajmërimi ose njoftimi mbi shkyçjen është marrë nga konsumatori në afat jo më pak se dy (2) ditë pune nga dita kur është dërguar ky njoftim. Këto veprime përfshijnë por nuk janë të kufizuara në:
- a) Telefonimi i konsumatorit, nëse ndërmarrja e energjisë e ka numrin kontaktues të konsumatorit,
  - b) Dërgimi i e-malit nëse ndërmarrja e energjisë e ka kontakt adresën elektronike, ose

- c) vizita e serishme e objektit të konsumatorit, nëse ndërmarrja e energjisë nuk e ka numrin e telefonit dhe as adresën elektronike të konsumatorit.

## **Neni19**

### **Kundërshtimi dhe Hetimi Përpara Shkycjes**

- 19.1.** Një ndërmarrje e energjisë nuk do ta shkyçë konsumatorin që i kundërshton në formë të shkruar arsyet për shkycje, duke pritur hetimin në lidhje me kundërshtimin, nga ndërmarrja e energjisë ose nga autoritetet tjera përgjegjëse.
- 19.2.** Në rast të këtyre kundërshtimeve, ndërmarrja e energjisë dhe/ose ZRRE-ja do të hetojnë për kontestin dhe do t'i komunikojnë konsumatorit vendimin e tyre brenda afatit të përcaktuar me Nenin 8.3 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjeve të Kontesteve në Sektorin e Energjisë të miratuar nga ZRRE-ja.
- 19.3.** Në varësi të rrethanave, konsumatorit mund t'i kërkohet të shpjegojë arsyet për aktin ose gabimin e supozuar, dhe të sigurojë ndonjë dokument të rëndësishëm relevant.
- 19.4.** Nëse objekt i kontestit bëhet një faturë, ndërmarrja e energjisë mund të mos shkyçë konsumatorin në bazë të mos-pagesës së shumës së plotë të faturës, derisa ndërmarrja e energjisë dhe ZRRE ta ketë shqyrtuar dhe të ketë bërë një vendim në lidhje me saktësinë e kësaj fature.
- 19.5.** Deri sa të bëhet rishikimi dhe vendosja, nga konsumatori do të kërkohet të paguaj:
- a) pjesën e faturës që është e pa kontestuar;
  - b) pjesa e faturës së pa kontestuar do të paguhet bazuar në mesataren e faturave të pa kontestuar të paguara prej konsumatorit gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm, ku fatura është lëshuar sipas një marrëveshjeje pagese që ka qenë në fuqi për dymbëdhjetë (12) muaj ose më gjatë; ose
  - c) mesataren e faturave të pa kontestuar të paguara prej konsumatorit gjatë tre (3) muajve, ku fatura është lëshuar sipas një marrëveshjeje pagese që ka qenë në fuqi për më pak se dymbëdhjetë (12) muaj.

## **Neni 20**

### **Lehtësim i përkohshëm për shkak të kushteve të konsumatorit**

- 20.1.** Ndërmarrja e energjisë do të shtyjë veprimin e shkycjes jo më gjatë se dhjetë (10) ditë kalendarike, nëse përpara njoftimit për datën e përcaktuar të shkycjes, konsumatori i siguron ndërmarrjes së energjisë një raport mjekësor të lëshuar nga një mjek i licencuar ose nga një zyrtar i shëndetit publik, ku vërtetohet se shkycja në shtëpinë/banesën e konsumatorit,

mund të jetë një kërcënim serioz dhe i menjëhershëm ndaj shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit apo anëtarëve të familjes së tij që banojnë në atë shtëpi/banesë

#### **Neni 21**

##### **Shkyçja e Ngrohjes gjatë Kushteve Ekstreme Klimatike**

**21.1.** Nëse me shkyçjen e furnizimit me energji rrezikohet jeta dhe shëndeti i konsumatorëve për arsye të temperaturave të ulëta, atëherë ndërmarrja e energjisë së ngrohjes qendrore nuk do të ndërmarrë veprime të shkyçjes gjatë motit të ftohët në dimër kur:

a) Temperatura më e lartë e ditës paraprake nuk e ka kaluar vlerën  $-3\text{ }^{\circ}\text{C}$ , dhe/ose

b) Raportet meteorologjike parashikojnë se moti do të mbetet në ose më i ulët se  $-3\text{ }^{\circ}\text{C}$  për 24 orët e ardhshme,

#### **Neni 22**

##### **Ekzekutimi i Shkyçjes Komerciale për Konsumatorin Individual**

**22.1.** Shkyçja komerciale për mos pagesë të faturave për shfrytëzim të energjisë të konsumatorëve individualë do të kryhet prej së paku nga dy (2) punëtorëve të ndërmarrjes së energjisë, në çdo ditë dhe në çdo kohë nëse konsumatorit i mundësohet pagesa në çdo kohë dhe në çdo ditë. Shkyçjet për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë mund të bëhen në çdo kohë nga së paku dy punëtorë të autorizuar të ndërmarrjes së energjisë.

**22.2.** Menjëherë pas kryerjes së një shkyçjeje, punonjësi i ndërmarrjes së energjisë do t'i dorëzojë konsumatorit Tabelën për Taksa dhe Gjoha përmes së cilës konsumatori do të njoftohet mbi dënimet që do të pasojnë në rast të rikyçjes pa leje.

**22.3.** Në rast se ndërmarrja e energjisë është e penguar fizikisht për të hyrë në objektin ku do të ndodhë shkyçja, ajo mund të kërkojë ndihmë nga organet zyrtare të sigurisë për ta ekzekutuar shkyçjen. Në lidhje me këtë ndërmarrja e energjisë mund të paraqesë raport mbi incidentin në gjykatën kompetente.

#### **Neni 23**

##### **Shkyçja nga Operatori i Sistemit të Transmisionit**

Nëse konsumatori është i kyçur në rrjetin e transmisionit dhe ai duhet të shkyçet për arsye të mos pagesës, apo shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, atëherë furnizuesi do të lëshojë një urdhër për shkyçje të Operatori i Sistemit të Transmisionit i cili është i obliguar të bëjë shkyçjen e konsumatorit në pajtim me procedurat për shkyçje të paraqitura në këtë Rregull.

## Neni 24

### Gjuha e Njoftimeve dhe Komunikata të tjera me Shkrim Ndaj Konsumatorëve

Përveçse nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga një marrëveshje e veçantë me shkrim, siç mund të jetë kontrata për furnizim me konsumatorin, të gjitha njoftimet për shkyçje dhe vërejtjet, si dhe komunikata të tjera me shkrim ndaj konsumatorëve, që kanë të bëjnë me shërbimet e ndërmarrjes së energjisë, do të shkruhen në gjuhën folëse të konsumatorit (shqip, anglisht dhe serbisht), në një mënyrë të qartë, të shkurtër dhe të kuptueshme.

## Kapitulli 5:

### RIKYÇJA E FURNIZIMIT ME ENERGJI

## Neni 25

### Afatet kohore dhe kushtet për rikyçje të furnizimit me energji

- 25.1.** Një ndërmarrje e energjisë do të rikyçë objektin e një konsumatori jo më vonë se dy (2) ditë kalendarike pasi të jetë zgjidhur arsyeja për shkyçje, përfshirë rastet kur konsumatori ka paguar shumën e faturave sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka nënshkruar një marrëveshje me ndërmarrjen e energjisë, ose ka kryer veprimin e kërkuar që ka qenë shkak për shkyçje.
- 25.2.** Nëse konsumatori me parashtrimin e një ankese me shkrim në Ndërmarrjen e energjisë, konteston arsyet për shkyçje, atëherë ndërmarrja e energjisë duhet që në afatin sa më të shkurtër kohor e jo më larg se 48 orë nga koha e ekzekutimit të shkyçjes ta rikyçë konsumatorin.
- 25.3.** Konsumatori i paregjistruar i cili është shkyçur nga rrjeti ngase është lidhur në rrjet pa pëlqimin e ndërmarrjes së energjisë, do të rikyçet në rrjetë vetëm pasi që të plotësojë këto kushte:
  - a) Aplikon për kyçje sipas Nenit 7 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji,
  - b) Nënshkruan marrëveshjen për kyçje në pajtim me Nenin 10 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, përfshirë taksat për kyçje;
  - c) Pagan për sasinë e energjisë të konsumuar në mënyrë të paautorizuar në pajtim me Nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Ndërmarrja e energjisë mund të nënshkruajë një marrëveshje me konsumatorin për pagesën e kësaj energjie me këste.
  - d) Nënshkruan kontratën për furnizim me furnizuesin.

- 25.4.** Konsumatori i peregjistruar nuk do të mund të parashtojë ankesë në ndërmarrjen e energjisë dhe as në ZRRE, pa i përmbushur kushtet e Nenit 25.3 edhe nëse se ai ka bërë parashtrim të ankesës te ndonjë autoritet tjetër.

## **Neni 26**

### **Heqja e Pajisjeve për Furnizimin me Energji**

- 26.1.** Heqja e pajisjeve për furnizimin me energji që i përkasin ndërmarrjes së energjisë, apo konsumatorit do të bëhet në rast se konsumatori kryen veprime të përcaktuar në Nenet: 5.3; 23.3; të kësaj rregulle.
- 26.2.** Përpara se të hiqen fizikisht të gjithë pajisjet e shërbimit, ndërmarrja e energjisë do të bëjë një regjistër të të gjitha aseteve që janë hequr, dhe do të mbajë një regjistër mbi dëmtimin e shkaktuar nga përdorimi i pakujdesshëm i këtyre prej konsumatorit. Regjistrat do të ruhen për të paktën një (1) vit ose deri në rikyçjen e shërbimeve të energjisë, varësisht cila paraqitet e para.
- 26.3.** Nëse ndërmarrja e energjisë është e penguar fizikisht për heqjen e pajisjeve të shërbimit, atëherë ajo do të kërkojë përkrahjen e organeve të sigurisë për ekzekutimin e këtij veprimi.

## **Neni 27**

### **Rikyçja nga Ndërmarrja e Energjisë**

- 27.1.** Ndërmarrja e energjisë mund të refuzojë të rikyçë konsumatorin, në rast të veprimit të përsëritur që rezulton me shkyçjen ose me mos-pagimin e përsëritur të faturës. Në këtë rast, ndërmarrja e energjisë është e autorizuar t'i heqë konsumatorit pajisjet për furnizimin me energji, sipas Nenit 26.
- 27.2.** Refuzimi për furnizim duhet të justifikohet me informacion me shkrim dhe mbi masat ligjore dhe administrative që janë në dispozicion të konsumatorit që kërkon të kundërshtojë këtë vendim.

## **Neni 28**

### **Kompensim i Konsumatorit që Pagan Rregullisht**

- 28.1.** Në rast se një ndërmarrje e energjisë nuk arrin të kryejë procedurën shkyçëse, të përcaktuar në këtë Rregull, një konsumator i prekur negativisht nga kjo, dhe që është i rregullt në pagesën e faturave të tij, ka të drejtë të marrë kompensim nga ndërmarrja e energjisë për dëmtime të drejtpërdrejta dhe të dëshmuara, që vijnë si pasojë e shkyçjes.
- 28.2.** Ndërmarrja e energjisë do të kompensojë konsumatorët e prekur duke siguruar një kredi ndaj faturave të ardhshme.

**28.3.** Ndërmarrja e energjisë në afat prej 120 ditësh pas aprovimit të kësaj rregulle duhet të paraqesë për aprovim tek ZRRE procedurën e kompensimit të konsumatorëve të cilët janë pagues të rregullt dhe janë shkyçur nga ndërmarrja e energjisë në kundërshtim me procedurën shkyqëse, të përcaktuar në këtë rregull.

**28.4.** Përlogaritjet e kompensimit të përcaktuar në 28 .2, do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit të Energjisë, dhe kontrata e nënshkruar me konsumatorin do të përmbajë kushtet përkatëse.

## **Kapitulli 6:**

### **MONITORIMI DHE DËNIMET**

#### **Neni 29**

##### **Raportimi, Monitorimi dhe Zbatimi**

**29.1.** ZRRE-ja do të monitorojë veprimet e ndërmarrja nga ndërmarrja e energjisë lidhur me procedurat e shkyçjes së përcaktuar në këtë Rregull, dhe në rast të mos-përputhjes, mund të ndërmarrë veprime detyruese kundër ndërmarrjes së energjisë.

**29.2.** Një ndërmarrje e energjisë duhet të mbajë regjistra për të gjithë shkyçjet dhe rikyçjet, dhe duhet t'i ruajë këta për të paktën tre (3) vjet.

#### **Neni 30**

##### **Dënimet**

**30.1.** Mosrespektimi i procedurave të paraqitura në këtë Rregull nga ndërmarrja e energjisë, do të paraqesin një shkelje dhe mund të jetë subjekt i gjobave sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

**30.2.** Kur vendos një gjobë, ZRRE-ja duhet të lajmërojë ndërmarrjen e energjisë për shkeljen e bërë, dhe duhet të sigurojë mundësinë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh kalendarike prej lajmërimit.

**30.3.** Nëse gjoba e vënë prej ZRRE-së nuk paguhet, ZRRE-ja duhet të fillojë procedura gjyqësore për mbledhjen e gjobës si borxh civil.

#### **Neni 31**

##### **Veprat Penale**

**31.1.** Ndërmarrja e energjisë mund të ushtron Kallëzim Penal në prokuroritë kompetente ndaj çdo personi i cili ka kryer veprime inkriminuese të përcaktuara ne Kodin e Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës

- 31.2.** Sipas Nenet 32.1, ndërmarrja e energjisë mund të paraqes padi ndaj çdo personi të tillë që ka shkatërruar, dëmtuar, ose hequr pa autorizim instalimet, ose pajisjet për energji elektrike, pajisjet për ngrohje qendrore dhe gaz, kabllo të nëntokësore apo nënujore ose pajisje të tjera të ngjashme.

## **Neni 32**

### **Shqyrtimi Gjyqësor**

- 32.1.** Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve, të nxjerra prej ZRRE-së, caktojnë procedurat me anë të cilave një konsumator ose një ndërmarrje e energjisë mund të paraqesë para ZRRE-së një mosmarrëveshje në lidhje me shkyçjen ose rikyçjen.
- 32.2.** Vendimet e ZRRE-së mund të jenë subjekt i apelimit në gjykatat përkatëse të juridiksionit të Kosovës.

## **Kapitulli 7 :**

### **DISPOZITA KALIMTARE**

## **Neni 33**

### **Zbatueshmëria e Shkyçjes Grupore**

- 33.1.** Ndërmarrja e energjisë mund të aplikojë shkyçje grupore vetëm në rastet e përcaktuara në këtë Rregull.
- 33.2.** Shkyçja grupore është masa kalimtare që mund të përdoret nga ndërmarrje e energjisë vetëm brenda periudhës gjashtë (6) mujore nga data e miratimit të kësaj Rregulle dhe në përputhje me procedurën e caktuar në këtë Rregull.

## **Neni 34**

### **Shkyçja Grupore**

- 34.1.** Shkyçja grupore do të përdoret si një mjet i fundit dhe ndërmarrja e energjisë duhet të përpiqet ta kufizojë në kohëzgjatje dhe shtrirje, sa më shumë që të jetë e mundur.
- 34.2.** Shkyçjet grupore mund të kryhen vetëm nëse një ndërmarrje e energjisë mund t'i demonstrojë me bindje ZRRE-së, se:
- a) një grup konsumatorësh mos-pagues për shkak të shkyçjes së propozuar, është një grup i kualifikuar; ose
  - b) Ndërmarrja e energjisë ka qenë fizikisht e përjashtuar nga leximi i njehsorit ose nga aktivitetet mirëmbajtëse brenda një zone të caktuar.
- 34.3.** Kur rrethanat e përmendura në paragrafin 34.2 nuk ekzistojnë më, konsumatorët e rregullt në pagesa, do të rikyçen në rrjet pa asnjë shpenzim të tyre.

**34.4.** Kur aplikon për aprovim të shkyçjes kolektive, ndërmarrja e energjisë duhet t'i paraqesë ZRRE-së, informacionin dhe/ose dokumentet vijuese:

- a) pikën fizike ku shkyçja kolektive do te ndodh;
- b) numrin dhe përqindjen e konsumatorëve brenda grupit të kualifikuar që nuk kanë bërë pagim të rregullt;
- c) kopjen e të gjithë faturave të pakontestuara, njoftimeve paralajmëruese dhe njoftimet shkyçëse, ose kopje të rëndësishme të regjistrave për çdo konsumator brenda grupit të kualifikuar; dhe
- d) prova se ndërmarrja e energjisë ka botuar një lajmërim publik në përputhje me Nenin 38.

## **Neni 35**

### **Botimi i Lajmërimeve Publike**

**35.1.** Përpara se të bëhet shkyçja kolektive, ndërmarrja e energjisë duhet të lëshojë një lajmërim publik për qëllimet e saj për të bërë një shkyçje grupore, në një gazetë me qarkullim të gjerë, në një afat kohor rreth pesë (5) ditë pune përpara datës që synohet të bëhet shkyçja grupore.

**35.2.** Një lajmërim i tillë publik do të përmbajë arsyet për shkyçjen grupore, të shpallë të

drejtën e çdo klienti të prekur që është i rregullt në pagesë, për të kërkuar kompensim prej ndërmarrjes së energjisë në bazë të kushteve të kësaj Rregulle, dhe ta përgatisë shpalljen në gjuhën shqipe, serbisht dhe anglisht.

**35.3.** Ndërmarrja e energjisë do të afishojë kopje të një lajmërimi të tillë në vende të dukshme në zonat përkatëse.

## **Neni 36**

### **Ekzekutimi i Shkyçjes Grupore**

**36.1.** Një shkyçje grupore, do të kryhet në përputhje me procedurën vijuese:

- a) Periudha e parë e shkyçjes do të zgjasë katërdhjetetë (48) orë;
- b) Menjëherë pas përfundimit të periudhës së parë të shkyçjes, ndërmarrja e energjisë do të rikyçë shërbimet për një periudhë pasuese prej jo më pak se katërdhjetetë (48) orësh;
- c) Nëse, me përfundimin e periudhës së parë të rikyçjes, situata mbetet e njëjtë dhe nevojitet sërish shkyçja grupore, ndërmarrja e energjisë do të aplikojë me shkrim në ZRRE për të aprovuar shtyrjen e periudhës së shkyçjes në një afat të caktuar kohor, sipas kushteve të identifikuar duke përfshirë dhe njoftimet shtesë për shkyçje.

- 36.2.** Aplikimi për aprovim të shtyrjes së periudhës së shkyçjes Grupore, do të përcjell procedurat e nxjerra në këtë Rregull dhe duhet të përfshijë edhe shumën e kompensimit që ndërmarrja e energjisë propozon t'u paguajë konsumatorëve, pagues të rregullt, si dhe ndonjë masë tjetër për të lehtësuar ndikimin e kundërt që ka kjo shkyçje ka të këta konsumatorë.
- 36.3.** Nëse, në ndonjë kohë gjatë shkyçjeve grupore, rrethanat për shkyçjen grupore ndryshojnë në mënyrë të tillë që ky kriter të mos përmbushet më, ndërmarrja e energjisë do të ndërpresë menjëherë shkyçjen grupore, të ktheje furnizimin me energji, dhe do të njoftojë menjëherë ZRRE-në.

### **Neni 37**

#### **Heqja e kushteve gjatë Periudhës Kalimtare**

- 37.1.** ZRRE-ja do të rishikojë të gjithë politikat dhe procedurat e ndërmarrjes së energjisë në fuqi, që kanë të bëjnë me shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve. Ndërmarrja e energjisë duhet t'i paraqesë politikat dhe procedurat e reja për aprovim tek ZRRE-ja brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas miratimit të kësaj Rregulle. Politikat dhe procedurat duhet të jenë në pajtim me ndryshimet/plotësimet që kanë ndodhë në këtë Rregull dhe në Rregullat tjera të miratuara nga ZRRE. ZRRE-ja do t'i rishikojë dhe do të marrë një vendim për aprovimin e këtyre politikave apo rikthimin e tyre për ripunim në aftin prej tridhjetë (30) ditë kalendrike pas paraqitjes së tyre në ZRRE.
- 37.2.** Sipas Nenit 38.1, heqja e ndonjërit prej kushteve të kësaj Rregulle mund të miratohet prej ZRRE-së vetëm nëse:
- a) kjo politikë nuk diskriminon ndonjë konsumator në baza kombëtare, racore, etnike ose në ndonjë bazë tjetër të ngjashme;
  - b) këto politika janë në fuqi vetëm për një fazë kalimtare prej gjashtë (6) muajsh maksimumi që prej datës së shpalljes së rregullës.
- 37.3.** Nëse prej shqyrtimit të politikave të ndërmarrjes së energjisë, ZRRE-ja kërkon informacione shtesë prej ndërmarrjes së energjisë për të justifikuar ose shpjeguar termat e politikave të veta, ndërmarrja e energjisë do t'i sigurojë ZRRE-së këtë informacion me shpejtësi, sipas kërkesës së ZRRE-së.

### **Kapitulli 8**

#### **DISPOZITAT TJERA**

### **Neni 38**

#### **Ndryshimi**

- 38.1.** Rregull mund të ndryshohet nga koha në kohë, që të zhvillohen objektivat e ZRRE-së, dhe do të kryhet me Vendimin e Bordit.

**38.2.** Çdo propozim për ndryshim do të dërgohet ZRRE-së në formë të shkruar ose do të iniciohet nga ZRRE-ja.

**38.3.** Vendimi do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, dhe nëse është e nevojshme edhe në gazetën ditore, TV dhe radio siçpë vendim të Bordit të ZRRE-së.

#### **Neni 39**

##### **Gjuha Zyrtare e Rregullit**

Rregulla nxirret në shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të ndonjë konflikti gjuhësor në lidhje me kuptimin e termave në këtë Rregull, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

#### **Neni 40**

##### **Publiciteti**

**40.1.** Rregulla është miratuar në sesion publik, në konsultimin publik dhe të botohet në Gazetën Zyrtare, Buletinin dhe faqen e zyrtare elektronike të ZRRE-së.

**40.2.** Ndërmarrja e energjisë do të informojë konsumatorët për dispozitat e këtij Rregulli me mënyrat më të përdorshme të postës dhe/ose lajmërimit në gazeta si dhe në media të tjera.

#### **Neni 41**

##### **Hyrja në Fuqi**

**41.1.** Rregulla do të hyjë në fuqi në datën e aprovimit të saj prej Bordit të ZRRE-së dhe publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

**41.2.** Dispozitat e kësaj Rregulle do të adresohen te të gjitha ndërmarrjet e energjisë që kryejnë shërbime publike, si dhe te konsumatorët e tyre në Kosovë.

**41.3.** Rregulla do të zëvendësojë të gjitha Urdhëresat, Vendimet dhe Udhëzimet të lëshuara lidhur me shkyçjen dhe/apo rikyçjen nga ana e ZRRE-së apo ndonjë Udhëzimi Administrativ të Qeverisë para nxjerrjes së kësaj Rregulle dhe pajtueshmërisë me dispozitat e saja.

**Shtojca 1: Tabela e Çmimeve dhe Gjobave**

1. Përgatitja dhe shpërndarja e lajmërimit për shkyçje dhe/ose rikyçje	5.00 €		
2. Shkyçja për konsumatorët familjarë	15.00 €		
3. Rikyçja për konsumatorët familjarë	15.00€		
4. Shkyçjet për ekonomit jo-familjare (konsumatorët komercialë).	30.00 €		
5. Rikyçja për ekonomit jo-familjare (konsumatorët komercialë)	30.00€		
6. Gjobat për Shkyçjet dhe rikyçjet për përdorim të Paautorizuar, njehsor të Manipuluar dhe Vjedhje.	1000 €		
7. Gjobat për Rikyçjet e paautorizuara nga konsumatorët e regjistruar të godinave pas shkyçjes së tyre nga ndërmarrja e energjisë (për konsumatorët familjarë dhe jo-familjarë) të regjistruar	Grupi Tarifor	Përshkrimi	Vlera
	1/1	110 KV-2	2.000 €
	1/2	35KV -2	2.000 €
	1/3	10KV -3	2.000 €
	4/01	0.4KV HH single TM-4	100 €
	4/02	0.4KV HH Double TM-4	100 €
	5/41	E parapaguar HH	100 €
	5/71	Tar.komerciale e parapaguar	300 €
	6/6	0.4KV Kat. 1-6	300 €
	7/01	0.4KV Kat.2njëtariforTM-7	300 €
	7/02	0.4KV Kat.2dytarifor TM-7	300 €
	8/01	Ndriçimi Publik-8	300 €
	9/01	Norma Fikse<400 kWh	100 €
	9/02	Norma Fikse 400-800 kWh	100 €
9/03	Norma Fikse >800 kWh	100 €	
8. Gjobat për ndërmarrjet energjetike që nuk veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi.	2,000.00 € për ndërmarrjen energjetike; 1/3 e rrogës së personit të autorizuar		